



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1469 Prot.

Tiranë, më 27 / 09 / 2019

V E N D I M

Nr.127 , Datë 27 / 09 / 2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr.108, datë 12.09.2019, të M. K, kundër Zyrës Arsimore Mat dhe Shkollës së Mesme të Bashkuar “Haxhi Lata”, Suç¹, me pretendimin për diskriminim për shkak “të gjendjes shëndetësore” dhe “të bindjeve politike”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Nëpërmjet Vendimit nr.119, datë 07.05.2018 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka vendosur konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit ardhur për shkak të aftësisë së kufizuar të M. K, nga ana e Zyrës Arsimore (ZA) Mat dhe Shkollës së Mesme të Bashkuar “Haxhi Lata”, (SHMB) Suç, vendim i cili ka ardhur në kuadër të shqyrtimit të ankesës me nr.134 Regj., datë 20.10.2017.

Subjekti ankues, M. K në parashtrimet e sjella pranë KMD-së ka ngritur disa pretendime, sipas të cilave ajo vijon të diskriminohet nga të njëjtat subjekte, duke specifikuar se:

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën SHMB Suç.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Së pari, SHMB Suç nuk ka ekzekutuar vendimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për ta rikthyer atë në pozicionin e punës si mësuese Biologji-Kimie në SHMB Suç.

Së dyti, nuk i kanë kthyer përgjigje kërkesës së saj të datës 24.05.2018 nëpërmjet së cilës ka kërkuar zbatimin e vendimit të KMD-së. Nga ana tjetër, ankuesja thekson se, nëpërmjet shkresës me nr.561 prot., datë 03.09.2018 ZA Mat ka nxjerrë Urdhrin nr.49, datë 03.09.2018 “Për emërim në detyrë” të saj në shkollën e mesme “Shaban Çollaku” Klos. ZA Mat ka cituar në këtë shkresë se ky emërim vjen si rezultat i krijimit të vendit vakant nga dalja në pension e mësuesit H. B, pranë kësaj shkolle, si dhe në zbatim të kërkesës së Komisionerit³.

Së treti, ankuesja shprehet se i ka kërkuar informacion ZA Mat lidhur me faktin e moszbatimit të vendimit të KMD-së dhe moskthimit përgjigje nga ana e SHMB Suç.

Konstatohet se nëpërmjet shkresës me nr.229 prot., datë 15.04.2019 ZA Mat ka informuar ankuesen se vendimin e KMD-së nuk e kanë zbatuar pasi ky vendim është në proces gjykimi në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë dhe ende nuk ka marrë formë të prerë.

Po ashtu nëpërmjet shkresës me nr.855 prot., datë 13.06.2018 KMD është shprehur qartë lidhur me zbatimin e Vendimit nr.119, datë 07.05.2018 të Tij.

Nga ana tjetër, ZA Mat citon se, fakti i emërimit të ankueses në profilin e saj si mësuese Biologji-Kimie në shkollën e mesme “Shaban Çollaku” Klos tregon përpjekjet e tyre për sistemimin e saj në punë. Ankuesja konteston procedurën e ndjekur për këtë emërim të saj.

Së katërti, ankuesja ka pretenduar se nga ana e SHMB Suç nuk është bërë shpallja e vendit vakant për pozicionin e mësuesit të lëndës Biologji-Kimi dhe se ajo ndjehet e diskriminuar edhe nga përgjigjja që ky institucion i ka kthyer asaj duke cituar se, ajo nuk mund të trajtohej si kandidate për këtë pozicion pune, përse kohë ka një emërim në një institucion tjetër si dhe për shkak se ajo nuk kishte paraqitur asnjë kërkesë për lëvizje paralele pranë ZA Mat. Në vijim të pretendimeve, lidhur me diskriminim të saj përmes moszbatimit të vendimit të KMD-së, ankuesja citon se KMD nuk ka vlerësuar drejt situatën e kthimit të ankueses në pozicionin që kishte pranë SHMB Suç, kur ka konsideruar si pamundësi objektive rikthimin e saj aty, si dhe nuk duhet të kishte marrë në konsideratë si zgjidhje të problematikës faktin e emërimit të ankueses në shkollën e mesme “Shaban Çollaku” Klos.

Veprimet e ndërmarra nga ana e ZA Mat për emërimin e saj në shkollën e mesme “Shaban Çollaku” Klos, ankuesja i sheh si sjellje diskriminuese për shkak të bindjeve të saj politike dhe si shkak i aftësisë së saj të kufizuar.

Së fundmi, ankuesja pretendon se nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë para ligjit nga vetë institucioni i KMD-së, duke cituar se: “KMD nuk ka zbatuar as vendimmarrjen e vet dhe se KMD për shkak të ndikimit që kanë institucionet nuk më ka ofruar mbrojtje dhe trajtim të barabartë para ligjit”.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjeve politike dhe të gjendjes shëndetësore të saj, nga

³ Shkresa me nr.855 prot., datë 13.06.2018.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Godina e Ish-Ministrisë së Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, ëb: www.kmd.al

ana e ZA Mat dhe SHMB Suç, si dhe rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës, si mësuese e lëndës Biologji-Kimi në SHMB Suç.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Neni 1 i Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcakton se “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Bazuar në shqyrtimin paraprak të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

- Sa i takon pretendimit të ankueses për diskriminim nga ZA Mat dhe SHMB Suç, lidhur me mos ekzekutimin e vendimit nr.119, datë 07.05.2018 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe për trajtim të pabarabartë para ligjit nga vetë institucioni i KMD-së, duke cituar se, nuk ka zbatuar as vendimmarrjen e vet; Komisioneri informon znj.Kuka se, Vendimi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është një akt administrativ, i cili, në rast mosdakortësie me të (megjithëse në rastin konkret nëpërmjet këtij akti, Komisioneri ka konstatuar pikërisht diskriminimin tuaj nga ana e ZA Mat dhe SHMB Suç) mund të kundërshtohet gjyqësisht.
- Nga ana tjetër, sikurse vetë ankuesja është shprehur, Vendimi nr.119, datë 07.05.2018 i KMD është akoma në proces gjykimi në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë dhe ende nuk ka marrë formë të prerë. Për rrjedhojë, në këto rrethana nuk mund të kërkohet

ekzekutimi i vendimit të KMD-së apo të vijohet me vendim gjobe për moszbatim të vendimit të KMD-së, përsa kohë kjo çështje është në proces gjykimi.

- Lidhur me pretendimin e ankueses se “KMD për shkak të ndikimit që kanë institucionet nuk më ka ofruar mbrojtje dhe trajtim të barabartë para ligjit”, Komisioneri i sugjeron asaj t’i drejtohet organeve kompetente, të cilat shqyrtojnë vendimmarrjen e Komisionerit.
- Lidhur me kërkesën e ankueses për konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjeve politike dhe të gjendjes shëndetësore të saj, nga ana e ZA Mat dhe SHMB Suç, si dhe rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës, si mësuese e lëndës Biologji-Kimi në SHMB Suç, Komisioneri vlerëson se, e njëjta kërkesë është shqyrtuar më parë nga Institucioni i KMD-së në kuadër të ankesës me nr. me nr.134 Regj., datë 20.10.2017 dhe për të është marrë Vendimi nr.119, datë 07.05.2018 i Komisionerit (moszbatimin e të cilit konteston ankuesja). Nëpërmjet këtij vendimi është konstatuar diskriminim në formën e viktimizimit ardhur për shkak të aftësisë së kufizuar të M. K, nga ana e ZA Mat dhe SHMB Suç dhe është urdhëruar rikthimi i saj në vendin e mëparshëm të punës.

Referuar nenit 33 pika 4c/ç të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “ c) ...e njëjta çështje është shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër dhe për të është marrë një vendim i mëparshëm... ç) ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, kërkesa nuk mund të pranohet.

- Lidhur me pretendimin e ankueses përsa i takon përgjigjes së KMD-së lidhur me konsiderimin e pamundësisë objektive për rikthim të saj në SHMB Suç si dhe konstestimit të emërimit të saj në shkollën e mesme “Shaban Çollaku” Klos; Komisioneri vlerëson se:
 - Referuar kronologjisë së ngjarjeve të ndodhura gjatë periudhës kohore të shqyrtimit të ankesës së M. K dhe periudhës të pas daljes së Vendimit nr.119, datë 07.05.2018 të Tij, rezulton se në SHMB Suç nuk ka patur vende të lira pune për mësuese të lëndës Biologji-Kimi, dhe në këto rrethana ishte i pamundur objektivisht rikthimi i saj aty.
 - Nga ana tjetër, emërimi i ankueses në profilin e saj si mësuese Biologji-Kimie në shkollën e mesme “Shaban Çollaku” Klos, u konsiderua si një zgjidhje e arsyeshme dhe e përshtatshme, duke qenë se vetë ajo nuk kishte shprehur kundërshti lidhur me këtë fakt. Bazuar në aktet me të cilat KMD ka komunikuar me ankesen⁴, ajo kishte shprehur shqetësim vetëm sa i takon faktit nëse emërimi i saj do të ishte real dhe konkret, pasi pretendonte se kishte informacion se ky pozicion pune mund të shkrihej si pasojë e rënies së ngarkesës mësimore.
 - Referuar komunikimit zyrtar të KMD me ZA Mat lidhur me sqarimin e pretendimit të ankueses dhe konkretizimin e masave për emërimin e saj, rezulton e provuar se emërimi i M. K si mësuese brenda profilit të saj është konkretizuar nëpërmjet Urdhrit nr.49, datë 03.09.2018 të ZA Mat dhe Vendimit nr.1, datë

⁴ E-mail i ankueses, datë 06.06.2018, nga adresa xx@yahoo.com, ora 2 :56 PM

Adresa: Rruga e Durrësit, (Godina e Ish-Ministrit të Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, ëb: www.kmd.al

06.09.2018, vendim për të cilin ajo është thirrur dhe njoftuar nga ZA Mat.

- Pra, në kontekst të sa mësipër, në kushtet kur vendimi i KMD-së nuk ishte kundërshtuar akoma gjyqësisht, ky emërim është konsideruar si një zgjidhje e arsyeshme nga Komisioneri dhe jo si veprim diskriminues i ndërmarrë ndaj saj.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, konkludojmë se nuk përmbushen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4c/ç, 7 dhe 10 të Ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së M. K, për shkak se nuk përmbushen kriteret ligjore të përcaktuara në dispozitat e ligjit 10 221/2010“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁵”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në gjykatë, brenda afatit 45 ditor nga marrja dijoni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar.

KOMISIONER

Robert GAJDA

**Në mungesë dhe me porosi,
DREJTORE JURIDIKE**

Ardiana HALA

Fusha: Punësim

Shaku: Bindjet politike, gjendja shëndetësore

⁵ Pika 1, neni 21, pika1/a, neni 32, dhe pikat 1,3,4c/ç të nenit 33, të LMD-së.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Godina e Ish-Ministrit të Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, ëeb: www.kmd.al